

Procesverbal i Takimit të 9-të të Grupit të aktorëve
për
Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

4 Mars, 2015
Dorcas Aid Albania, Korçë,
Republika e Shqipërisë

Pjesëmarrësit në takim:

Struktura e pjesëmarrësve në takimin e 9-të të Grupit të Aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” ka përfshirë 26 antarë të emëruar dhe të rinj të mundshëm për Rajonin e Prespës. Takimi u organizua dhe u facilitua nga Stafi i Njësise së menaxhimit të Projektit me asistencën e Presidentes dhe Zëvendës-Presidentit të grupit të palëve të interesuara për rajonin ndërkufitar “Prespa”.

Lista e plote e pjesëmarrësve dhe detaje për kontaktet e tyre mund të gjenden në:

ANNEX 1: Lista e pjesëmarrësve të takimit të 9-të të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” 04.03.2015

ANNEX 2: SCAN Lista e pjesëmarrësve të takimit të 9-të të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” 04.03.2015

ANNEX 3: PPP - Përmbledhje e aktiviteteve gjatë fazës së dytë të projektit

ANNEX 4: PPP – Zvillimi Ekonomik i Integruar dhe aktivitete në të ardhmen për rajonin Prespa

Programi i takimit:

Takimit i 9-të i Grupit të aktorëve Për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

10:30 - 11:00	Mbërritja e pjesëmarrësve dhe takimi i mirëseardhjes
11:00 – 11:10	Fjalimi i mirëseardhjes Z. Ilija Dishnica Drejtori ekzekutiv Dorcas Aid Albania Korçë Përfaqësues nga Këshilli Rajonal Qarku Korçë
11:10 – 11:20	Hapja zyrtare dhe prezantimi i programit Znj. Viola Bogdani, Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin "Prespa" Z. Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”
11:20 – 11:40	Përmbledhje e aktiviteteve gjatë fazës së dytë të projektit Znj. Etleva Thimo, Asistente Teknike – “Prespa” CBR
11:40 – 12:10	Aktivitete të grupit të aktorëve “Prespa” dhe promovimi i rajonit “Prespa” në evente të tjera Znj. Etleva Thimo, Asistente Teknike – “Prespa” CBR, Trajnimi mbi “Partneritetet dhe Rrjetëzimi” Znj. Orieta Glozeni - DMO Albania, Panairi Internacional i turizmit – Beograd Z.Vlado Ivanovski – Resgrup, aktiviteti i Njerëzit tek Njerëzit mbi Kooperativat Bujqësore – udhëheqësi i ndryshimit
12:10 - 12:40	Pushim kafe
12:40 – 13:10	Diskutim për fazën e ardhshme të programit ABDA Z. Damjan Surlevski, Koordinator Rajonal – “Prespa” CBR

13:10 – 13:30	Konkluzionet e takimit Z. Damjan Surlevski, Koordinator Rajonal – “Prespa” CBR
13:30 - 15:00	Dreka
15:00	Kthimi

Procesverbal i takimit

Takimi u hap me fjalën e mirëseardhjes nga Koordinatori Rajonal për rajonin ndërkufitar "Prespa" Z. Damjan Surlevski, i cili falenderoi pjesëmarrësit për prezencën dhe uroi një bashkëpunim sa më të frutshëm me të gjithë aktorët.

Më pas në emër të Dorcas Aid Albania Korçë, drejtori ekzekutiv Z. Ilia Dishnica, përshëndeti takimin dhe shprehu rëndësinë e takimeve të tilla që prej fillimit të organizimit të grupit të palëve të interesuara. Kështu ai theksoi vlerën e jashtëzakonshme që kanë patur këto takime në mbledhjen e informacionit, projekt idetë konkrete të nxjerra nga vetë grupi i aktorëve si edhe mbështetjen e vazhdueshme që Qarku Korçë i ka dhënë projektit. Ai shprehu, kështu kënaqësinë për përfshirjen në aktivitetet të tilla të rëndësishme për rajonin dhe njëkohësisht optimizimin për kohëzgjatjen dhe suksesin e projektit në të ardhmen.

Në vazhdim Znj. Viola Bogdani, Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin "Prespa" pasi përshëndeti pjesëmarrësit theksoi rëndësinë e krijimit dhe konsolidimit të grupit të qëndrueshëm të aktorëve të palëve të interesuara “Prespa”, pavarësisht sfidave të hasura që prej fillimit të projektit.

Më pas, Z.Naume Tashovski, Zëvendës President i Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa” pasi falenderoi dhe uroi pjesëmarrësit, prezantoi ne detaje programin e takimit duke u ndalur në cdo sesion të programit.

Sesioni 1

Përmbledhje e aktiviteteve gjatë fazës së dytë të projektit

Sesioni nisi me prezantimin e Znj. Etleva Thimo, e cila bëri një përmbledhje të aktiviteteve të realizuara gjatë fazës së dytë të projektit duke u ndalur në përshkrimin e secilit aktivitet të realizuar. Kështu, pjesëmarrësit u informuan mbi konkluzionet e secilit aktivitet, progresin dhe veprimet e ndërmarra, rëndësië e organizimit për rajonin dhe përfshirjen e aktorëve të grupit të palëve të interesuara. Gjithashtu fokus i prezantimit ishte vlera e organizimit të aktiviteteve të cilat kanë shërbyer si një mundësi shumë e mirë e promovimit të rajonit Prespa, duke ju dhënë mundësinë aktorëve të grupit të palëve të interesuara të shkëmbejnë njohuritë dhe informacione mes tyre.

Gjithashtu u realizua edhe një prezantim i shkurtër lidhur me aktivitetet e grupit të palëve të interesuara në evente të tjera, duke dhënë një përmbledhje të trajnimit të

organizuar mbi “Partneritetet dhe Rrjetëzimi” në Banja Koviljaca, Sërbi si edhe aktivitetin e programit Njerëzit tek Njerëzit “Konferenca e Kooperativave Bujqësore – udhëheqësi i ndryshimit”, Ohër, Maqedoni.

Në diskutimet e ndryshme të realizuara nga aktorët pjesëmarrës u theksua rëndësia e organizimit të aktiviteteve rreth kooperativave bujqësore sidomos për rajonin e Korcës i cili përballet me sfida të dukshme në këtë sektor. Në vazhdim të këtij diskutimi duke parë problematikat social ekonomike të rajonit u sugjerua ndërmarrja e aktiviteteve të tilla edhe në sektorë të tjerë socialë.

Gjithashtu gjatë diskutimit o konkludua se sfidat e hasura gjatë fazës së dytë të projektit mbi mos pjesëmarrjen aktive të shumë komunave në takime mund të lehtësohen me ndarjen e re administrative që do të ndodhë në gjithë territorin e Shqipërisë.

Sesioni 2

Aktivite të grupit të aktorëve “Prespa” dhe promovimi i rajonit “Prespa” në evente të tjera

Gjatë këtij sesioni Znj. Orieta Glozheni prezantoi shkurtimisht mbi organizimin e Panairit Internacional të Turzimit në Beograd dhe përfshirjen e grupit të aktorëve të palëve të interesuar nga rajoni Prespa në këtë event. Gjithashtu Znj. Glozheni prezantoi detaje të eventit duke u fokusuar në promovimin (prezantimin dhe marketingun) e rajonit Prespa në Panair.

Gjatë prezantimit ajo theksoi edhe konkluzionet e nxjerra duke u ndalur tek mungesa e informacionit për rajonin e Prespës, organizimi i takimeve B2B në prezantimin dhe shitjen e rajonit të Prespës si dhe promovimin e paketave dhe internerareve nën sloganin “dy vende një destinacion”.

Në diskutimet e ndryshme të realizuara nga aktorët pjesëmarrës u theksua rëndësia e njohjes të rajonit të Prespës për të tërhequr sa më shumë vizitorë me qëllim zhvillimin e turizmit në rajon. Gjithashtu u theksua se zhvillimi kërkon kohën e tij dhe se mos financimi i fazës së tretë të parashikuar për projektin sigurisht përbën një pengesë, por vazhdimësia e punës në të ardhmen nuk do të mungojë.

Gjithashtu komente të tjera gjatë diskutimit u lidhën me sugjerime të ndryshme se çfarë mund të bëhet konkretisht duke sugjeruar mbështetjen e produkteve artizanale, strategji për studimin e zonës, studimin e tregut, krijimin e një seri ofertash të paketave turistike të unifikuara me pjesën Maqedonase dhe atë Shqiptare të Prespës, financim për rritjen e vizibilitetit të zonës si edhe financim për çështje të tjera problematike social ekonomike.

Gjithashtu në vazhdim të diskutimeve Z. Olsi Duma drejtues i Parkut Kombëtar “Prespa” sugjeroi duke ftuar pjesëmarrësit dhe organizatorët që në vazhdimësi të realizohet një takim në ambjentet e Parkut Kombëtar “Prespa” dhe më pas të zhvillohet nje turistik në Park me qëllim njohjen edhe më nga afër të rëndësisë dhe potencialit të zones. Sugjerimi u miratua nga të gjithë pjesëmarrësit.

Sesioni 3

Diskutim për fazën e ardhshme të programit ABDA

Në fillim të këtij sesioni Z. Damjan Surlevski bëri një prezantim të zhvillimit ekonomik të integruar si një lehtësim i rretëzimit dhe bashkëpunimit midis popullatës lokale, sipërmarrësve, zejtarëve, sektorit të vogël bujqësor, ofruesit e shërbimeve të turizmit dhe aktorëve të tjerë të komunitetit rural në rajonet ndërkufitare, organizimin e proceseve të punës të përbashkët, ndarjen e burimeve dhe vendosjen në treg të ofertave të përbashkëta. Gjithashtu në prezantimin e tij Z. Damjan Surlevski theksoi rëndësinë e krijimit të faqes web për rajonin e Prespës, si një platformë e cila do të shërbejë për vendosjen e informacionit mbi aktivitete të ndryshme, njerëzit e përsirë dhe kontaktet e tyre duke ndihmuar kështu në komunikimin e vazdueshëm në të ardhmen.

Në vazhdim të prezantimit Z. Surlevski paraqiti edhe tre projekt idetë e krijuara nga grupi i palëve të interesuar si një potencial i mundshëm për tu realizuar në të ardhmen; Prespa në dorën tuaj - përmirësimi dhe promovimi i ofertës turistike rajonale; Fara të reja për bio-trashëgimninë - Mbrojtja e potencialit natyror; Gratë e Prespës kohezioni socio-ekonomik - Forcimi i kohezionit social dhe pozitës ekonomike të grave. Në përfundim të prezantimit Z. Damjan Surlevski duke u ndalur tek rëndësia e qëndrueshmërisë së projektit bëri një prezantim të qasjes ABD në kontekstin e bashkëpunimit ndërkufitar Maqedoni-Shqipëri dhe mundësinë e aplikimit të projekt ideve përmes mbështetjes së programeve CBC.

Në diskutimet e realizuara mbi sesionin e tretë antarë të grupit të palëve të interesuara theksuan se programet Njerëzit tek Njerëzit janë një mundësi shumë e mirë aktivitetesh dhe se në të ardhmen duhet një angazhim edhe më i madh prej grupit të palëve të interesuara për aplikime. Gjithashtu u theksua edhe veshtirësia që hasin disa nga antarët e grupit për të aplikuar në projekte për mungesë kapacitetesh në shkrimin e projekteve. Kështu ata shprehën nevojën për ngritjen e kapaciteteve për shkrimin e projekt propozimeve, sidomos nga përfaqësues nga Korca. Në përputhje me këtë koment, përfaqësues nga Bashkia e Resnjës dhe Zyra e menaxhimit të programit, shprehën gadishmërinë të mbështesin partnerët në këtë çështje.

Gjithashtu në përfundim të diskutimeve u sugjerua që në takimet në vazhdimësi pjesë e pjesëmarrësve të ftuar në takime të jenë edhe përfaqësues nga ministritë përkatëse me qëllim njohjen më nga afër të grupit të palëve të interesuara dhe promovimin e punës së grupit.

Në përgjigje të komenteve nga antarë të grupit, lehtësuesit e takimit vlerësuan sugjerimet e pjesëmarrësve dhe mbështetën maksimalisht komentet e tyre mbi

nevojat që ata kanë dhe bashkëpunimin për vazhdimësinë.

Sesioni 4

Konkluzione dhe mbyllja e takimit

Në sesioni e fundit u dhanë konkluzionet si mëposhtë duke kaluar në secilin prej përfundimeve të vendosura në takimin e mëparshëm të grupit të palëve të interesuara si mëposhtë:

- Faqja web për rajonin për Prespën është krijuar dhe në vazhdimësi do të pasurohet me më shumë informacion mbi aktivitete, projekte dhe kontakte lidhur me rajonin;
- Broshurat promovuese nuk janë përkthyer akoma në gjuhët lokale (Maqedonisht dhe Shqip) sipas sugjerimit të anatrëve të grupit, por ky proces do të vazhdojë edhe në të ardhmen gjatë fazës tjetër.
- Kopje të broshurave ekzistojnë në Zyrën për menaxhimin e programit “Prespa”, në Korçë dhe do të vazhdojnë të shpërndahen sipas nevojave dhe kërkesave të grupit të palëve të interesuara;
- Zyra për menaxhimin e programit “Prespa” do të vazhdojë të mbështesë idetë dhe do të ndihmojë në koordinimin e aktiviteteve potenciale që mund të mbështeten nga programi “Njerëzit për Njerëzit”. Deri tani tre aktivitete janë realizuar dhe një tjetër pritet të realizohet gjatë mes muajit Mars 2015;
- Më qëllim promovimin e aktiviteteve dhe punës së bërë në rajon dhe gjithashtu shpërndarjen e informacionit me antarët e grupit të palëve të interesuara do të realizohet krijimi i një faqeje në Facebook për rajonin ndërkufita “Prespa”;
- Pavarësisht rezultateve jo fort pozitive të deritanishme, Zyra për menaxhimin e programit “Prespa” do të vazhdojë lobimin me autoritete lokale mbi rëndësinë e rikonstruksionit të infrastrukturës rrugore lokale në rajonin “Prespa”;
- Ndërmjet tre projekt ideteve të krijuara nga grupi i palëve të interesuar:

Prespa në dorën tuaj - përmirësimi dhe promovimi i ofertës turistike rajonale;
Fara të reja për bio-trashëgimninë - Mbrojtja e potencialit natyror; Gratë e Prespës kohezioni socio-ekonomik - Forcimi i kohezionit social dhe pozitës

ekonomike të grave; projekt ide të tjera që mund të kontribuojnë në integrimin e zhvillimit ekonomik të rajonit dhe që duhet të fokusohen në të ardhmen janë:

- Rivitalizimi i prodhimit tradicional të punës me dorë të qeramikës dhe produkteve artizanale të tjera në të dy anët e rajonit Prespa;
- Aktivitete për promovimin dhe krijimin e kooperativave, grupeve prodhuese, grupimeve të ndryshme etj. (kryesisht në sektorin bujqësor) por gjithashtu edhe në sektorë të tjerë si turizmi dhe përpunimi;
- Aktivitete për krijimin e produkteve dhe ofertave turistike të unifikuara për promovimin përmes takimeve B2B, panairove, konferenca për ofruesit e shërbimeve turistike dhe operatorëve në gjithë botën;
- Zyra për menaxhimin e programit “Prespa” dhe SWG do të shërbejë si një pikë informative ku antarët e grupit (SHG) të marrin informacion për thirrje për projekt propozime e programe si edhe do të mbështese në përgatitjen e aplikimeve dhe realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta në rajon;
- Rritja e vizibilitetit të aktiviteteve të programit ABDA dhe rajonit Prespa do të mbështetet edhe nga antarë të grupit (SHG) me promovimin përkatës në nivel lokal;
- Antarë të grupit të palëve të interesuara morrën pjesë në panairin e turizmit në Beograd dhe kontribuan në promovimin e ofertave turistike, atraksioneve dhe gastronomisë në rajonin Prespa.
- Në takimet në vazhdimësi përfaqësues nga ministritë përkatëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural nga të dy shtetet do të ftohen të marrin pjesë në takimet e grupit të palëve të interesuara (SHG) me qëllim njohjen më nga afër të punës së grupit në rajonin Prespa;

Përgatiti:

Etleva Thimo

Asistent Teknik

Rajoni Ndërkufitar Prespa